




# PASQYRIMI I PUNËS KUVENDI KOMUNAL PODUJEVË

JANAR - DHJETOR 2023



Mars, 2024

E drejta e autorit © 2023. Organizata DEMOKRACIA FILLON KËTU-DFK. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe kontrollimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret sërish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjete elektronik, mekanik, fotokopjohet, incizohet apo tjera, pa lejen paraprake të DEMOKRACIA FILLON KËTU-DFK.

Raporti i përgatitur nga:

Organizata DEMOKRACIA FILLON KËTU-DFK - Mars 2024

## Përmbajtja:

Përmbledhje Ekzekutive .....	4
Hyrje .....	5
Përbërja e kuvendit.....	6
Përmbledhje e të dhënave.....	6
Shqyrtimi i Ligjshmërisë.....	7
Zhvillimi i Punimeve të Kuvendit Komunal .....	8
Menaxhimi i kohës për diskutime .....	8
Ndërhryjet në Punën e Kuvendit .....	8
Pengesat gjatë zhvillimit të diskutimeve.....	8
Prezenca e anëtarëve të Kuvendit .....	8
Mungesat sipas anëtarëve të Kuvendit Komunal .....	9
Angazhimi në seanca.....	10
Renditja e Asambleistëve sipas numrit të diskutimeve (2023) .....	11
Ushtrimi i detyrave dhe përgjegjësiive të kuvendit komunal Hartimi i Politikave .....	12
Vendimmarrja .....	12
Përdorimi i e-mailave zyrtarë.....	12
Pyetjet për Ekzekutivin .....	12
Propozimet për pika të reja të rendit të ditës.....	13
Prezenca e qytetarëve .....	13
Zbatimi i Planit të Punës të Kuvendit/Mbikëqyrja e Ekzekutivit .....	14
Realizimi i planit (Janar – Dhjetor) 2023 .....	16
Referuar planit të punët të planifikuara sipas kategorive:.....	16
Komunikimi i Këshilltarëve Komunalë me qytetarë .....	17
Grupat e Kuvendit .....	17
Këshillat Lokalë .....	17
Transparenca dhe Llogaridhënia .....	17
Konsultimet Publike dhe Shtojcat e Proceseve Buxhetore .....	18
Konkluzione: .....	19
Rekomandime:.....	20
Për Ekzekutivin Komunal.....	20
Për Administratën Komunale .....	20
Për Kryesuesin e Kuvendit Komunal .....	20
Për Anëtarët e Kuvendit Komunal.....	20

## Përmbledhje Ekzekutive

Duke pasur parasysh se sistemi qeverisës në Republikën e Kosovës është një shkallësh, qeverisja lokale është adresa e parë ku qytetari merr shërbimet. Në të njëjtën kohë, legjislacioni komunave u ka dhënë autonomi të lartë të qeverisjes nëpërmes kompetencave të bartuara, të deleguara dhe të zgjeruara. Një segment i rëndësishëm që parash legjislacioni është forcimi i demokracisë së drejtpërdrejtë duke e vendosur në kapitull të veçantë. Përveç detyrave, përgjegjësive dhe obligimeve të harmonizuara me nivelin qendror të rregulluara me ligjet dhe aktet nënligjore për qeverisjen lokale, ka edhe shumë përgjegjësi dhe shërbime që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve në vend. Në këtë kontekst, qeverisja lokale ka dy lloj përgjegjësish : e para, të ndikojë në përmbushjen e detyrimeve të qeverisjes në tërësi në sistemin politik; dhe e dyta, të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në nivel lokal në bazë të kompetencave ligjore.

Themelet e qeverisjes lokale janë vendosur në parime të qeverisjes së mirë, në frymën e kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, që ka për synim subsidiaritetin si mundësi që ofron vendimmarrjen dhe shërbimin sa më afër qytetarit. Në kontekstin e Kosovës, përkundër progresit, trazicioni i gjatë ka ndikuar që të ekzistojë një hendek në mes qytetarëve dhe vendimmarrësve. Kur marrim për bazë këto, nënkuptohet se autoritetet lokale kanë shumë punë për të bërë në arritjen e një qeverisje të mirë lokale. Për të pasur një qeverisje lokale sa më të pranuar nga qytetarët, nevojitet një aktivizim dhe angazhim shumë dimensional dhe një gjithpërfshirje e aktorëve që mund të japin kontribut në qeverisjen lokale siç janë: zyrtarët publik të zgjedhur dhe të emëruar, qytetarët politikisht aktiv dhe shoqëria civile qytetarët në përgjithësi. Para se gjithash është e rëndësishme që politik-bërja dhe vendimmarrja të kaloj nëpërmes duarve të qytetarëve dhe që ata të ndjejnë pronësi mbi të.

Strategjia për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026 e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës synon një avancim të qeverisjes lokale, duke përfshirë shoqërinë civile në politik-bërje dhe vendimmarrje. Angazhimi kuptimplotë i shoqërisë civile nënkuptohet një nivel i avancuar i bashkëpunimit, për të siguruar politika lokale efikase dhe efektive, përmirësuar përceptimin publik ndaj qeverisjes, dhe duke forcuar mirëbesimin e ndërsjell autoritete lokale – shoqëri civile. Për më shumë, themelimi i Këshillit për Bashkëpunim shoqëri civile-qeveri dhe miratimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023 i garanton shoqërisë civile një pjesëmarrje me të sigurtë dhe një hapësirë më të mirë veprimi.

Obligime tjera për përfshirje të organizatave nga shoqëria civile në politik-bërjen lokale dalin edhe nga dokumentet për integritet evropiane. Marrëveshja për Stabilizim Asociim në mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian nxjerr kërkesa që duhen përmbushur nga niveli lokal i qeverisjes. Shumë nga ato obligime parashihen të përmbushen, pikërisht duke bashkëpunuar me shoqërinë civile, forcuar rolin mbikëqyrës dhe avokues të organizatave të shoqërisë civile nga vetë komunat dhe duke ndarë buxhet të mjaftueshëm për të rritur kapacitetet e OSHC-ve. Kështu, bashkëpunimin me shoqërinë civile, autoritetet lokale duhet parë si një arritje të qeverisjes lokale dhe avancim të qeverisjes në tërësi.

Ky raport dhe të gjeturat nga aktiviteti i monitorimit nga Demokracia Fillon Këtu-DFK me qëllim ndikimi në përmirësimin e qeverisjes lokale, duhet parë në kontekst të përmbushjes së parimeve të qeverisjes së mirë dhe në veçanti në forcimin e partneritetit të qeverisjes lokale me shoqërinë civile.

## Hyrje

Raporti përmbledh të gjetura nga aktiviteti monitorues i punës së Kuvendit Komunal dhe koordinimit me ekzekutivin në Komunën për periudhën Janar - Dhjetor 2023.

Në kuadër të këtij raporti më në hollësi gjenden të dhëna në lidhje me zbatimin e legjislacionit nga Kuvendi Komunal në kryerjen e detyrave; zbatimin e rolit mbikëqyrës ndaj ekzekutivit, angazhimin e grupeve politike të përfaqësuar në Kuvend dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me politik-bërjen dhe vendimmarrjen nga Kuvendi, duke përfshirë edhe qeverisjen në përgjithësi.

Raporti pasqyron të gjeturat e monitorimit për funksionimin e Kuvendit të Komunës së Podujevës, duke përfshirë elementet si: transparencën e Kuvendit dhe Ekzekutivit, qasjen institucionale në raport me qytetarët, menaxhimin e seancave nga Kryesuesi i Kuvendit, publikimin e njoftimeve në Ueb faqen e Komunës, funksionimit të e-mailave zyrtarë, punën dhe performancën e asamblesitëve, duke tentuar që të kemi një pasqyrë më të qartë të përmbushjes së indikatorëve që garantojnë një qeverisje të mirë lokale.


Pjesëmarrja dhe përfshirja e qytetarit në politik-bërje dhe vendimmarrjen e komunës së Podujevës, është parakusht për funksionimin e trekëndëshit Ekzekutiv-Kuvend-Qytetarë. Ky raport synon të pasqyroj të përmbledhura të gjeturat nga monitorimi lidhur me përmbushjen kompetencave dhe obligimeve ligjore.

Menaxhimi, ushtrimi dhe përmbushja e kompetencave ligjore nga ana e kryetarit, si mbikëqyrja efikase nga kuvendi dhe roli i shoqërisë civile në rritjen e kërkesave për transparencë dhe llogaridhënie janë vendosur në fokus të raportit. Raporti ofron informacion, të dhëna lidhur me funksionimin e Kuvendit Komunal, vendimet dhe raportet me Ekzekutivin dhe qytetarët.

Raporti në pjesë të ndara do të paraqes, punën e Kuvendit Komunal, duke përfshirë: Menaxhimin e Punës së Kuvendit Komunal; Menaxhimin e Kohës për Diskutim; Prezencën e Anëtarëve të Kuvendit në Seanca; Angazhimin e Këshilltarëve në Seanca; Pengesat gjatë Zhvillimit të Diskutimeve; Gjuhën jo-parlamentare; Vendimmarrjen; Përdorimin e e-mailave zyrtarë; Pytjet për Ekzekutivin; Propozimet për pika të reja të rendit të ditës; Prezencën e Qytetarëve; Zbatimin e Planit të Punës; Mbikëqyrja e Ekzekutivit nga Kuvendi; Komunikimin e Këshilltarëve Komunalë me Qytetarë; Transparencën, Llogaridhënien dhe Diskutimet Publike.

## Përbërja e kuvendit

Kuvendi Komunal, ka gjithësej tridhjetëepesë (35) anëtarë; krahasuar mes dy mandateve (2017 – 2021), Referuar të dhënave nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, del se nga tridhjetëepesë (35), këshilltar komunal, ndryshimi në stukturë është tridhjetë (30) këshilltarë, apo 85.71%. Ku vetëm pesë (5) këshilltarë apo 14.29%, janë rizgjedhur nga mandati paraprak (2017).



Përbërja gjinore reflekton kështu:

Njëzetetë (23) burra; 65.71% dymbëdhjetë (12) gra, apo 34.29%.



**Nga kuota e përfaqësimit gjinor kanë marrë mandate pesë (5) gra, apo 41.7%;**

- LDK (Tringa Sfishta)
- VV (Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qendresë Hajrizi)
- PDK (Endritë Murati; Mimoza Stublla);

**Në garë të barabartë, kanë marrë mandate pesë (5) gra, apo 41.7%;**

- LDK (Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Donjetë Sheqiri)
- VV (Adelina Stublla);


**Bartëse liste, nga listat fituese kanë marrë mandate dy (2) gra, apo 16.66%;**

- PDK (Floretë Zejnullahu e zëvendësuar nga Mimoza Stublla);
- AAK (Mrika Thaçi).



## Përmbledhje e të dhënave

Në këtë pjesë janë paraqitur çështjet të cilat janë diskutuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës për periudhën e monitorimit (Janar – Dhjetor) 2023, gjegjësisht për pesëmbëdhjetë (15) seancat e mbajtura për këtë periudhë, tetë (8) të rregullta, katër (4) të jashtëzakonshme dhe tri (3) solemne.



Në kuadër të këtyre seancave, janë diskutuar çështje me gjithsej nëntëdhjetetë (98) pika të rendit të ditës.

Një (1) seancë e jashtëzakonshme është thirrur nga 12 asambleist (LDK)Tri (3) seanca të jashtëzakonshme, janë thirrur me kërkesë të kryetarit të komunës, me pesë (5) pika të rendit të

ditës:

### Seanca e parë (1) e jashtëzakonshme:

Një (1) seancë është thirrur nga Këshilltarët Komunal, me kërkesën e 12 këshilltarëve komunal, e inicuar nga grupi politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) me këto pika të rendit të ditës:

1. Diskutim rreth vërshimeve në Komunën e Podujevës;

### Seanca e dytë (2) e jashtëzakonshme:

1. Raporti përfundimtar i Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
2. Rishqyrtimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025.


### Seanca e tretë (3) e jashtëzakonshme:

1. Propozim Vendimi për shpalljen në interes të përgjithshëm publik të disa Pronave Shoqërore të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

### Seanca e katërt (4) e jashtëzakonshme

1. Propozim Vendimi për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023
2. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare Klubin e Futbollit K.F. Ilapi 1932” SH.P.K

Në tabelë paraqiten të dhëna për natyrën e pikave të cilat i ka trajtuar Kuvendi Komunal në Podujevë; Raporte dhjetë (10); Rregullore dy (2); Vendime, shtatëdhjetëkatër (74); dhe Informata, tri (4); Nga 63 vendime të marra në periudhën janar-dhjetor 2023, pesë (5) prej tyre, nuk janë publikuar si rrjedhojë e vlerësimit jo në harmoni me ligjslacionin në fuqi nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;



## Shqyrtimi i Ligjshmërisë

Në këtë periudhë në procesin e shqyrtimit të ligjshmërisë, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokale dhe Ministrinë e Linjës janë kthyer për rishqyrtim gjashtë (6) akte komunale, prej tyre dy (2) të ripërsëritura.

- Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit - Shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës. **(MAPL kërkesë për rishqyrtim të aktit);**
- Vendim për kompensimin e anëtarëve të komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e komunës së Podujevës. **(MFPT vlerësim jo në harmoni me ligjin dhe rekomandim që lidhur me këtë të drejtoheni në MPB);**
- Vendim për miratimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në komunën e Podujevës 2023-2027 **(MMPH kërkesë për rishqyrtim të aktit);**
- Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektivit - shtëpi për qëndrim ditor të personave të moshuar në qytetin e Podujevës – **(Procedurë e rishqyrtimit);**
- Vendim për miratimin e Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2023/27 **(Procedurë e rishqyrtimit);**
- Vendim për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025 **(Procedurë e rishqyrtimit);**

## Zhvillimi i Punimeve të Kuvendit Komunal

Përkundër vështirësive, Kuvendi Komunal për këtë periudhë ka pasur një rrjedhë normale të punës. Megjithatë, nga monitorimi vlerësohet se mund të eksplorohej mundësi për avancim të gjendjes, qoftë me përgatitjen e agjendës apo rrjedhën e punës në seanca. Në disa raste, si pasojë e mos konfirmimit të sakt, apo interpretimit, është ripërsëritur procesi i votimit.

Kuvendi Komunal ka mungesë të theksur të hapësirave të punës, përveç Kryesuesit asnjë nga Grupet e Këshilltarëve nuk kanë hapësira të veçanta pune. Në të njëjtën kohë, salla ka hapsirë të pa mjaftueshme që nuk lejon punë efikase, vështirëson menaxhimin e seancave dhe pamundëson monitorimin e organizatave dhe pjesëmarrjen e qytetarëve.

### Menaxhimi i kohës për diskutime

Rregullorja e punës së Kuvendit Komunal e përcakton qartë kohën e lejuar për diskutim të çështjeve nga anëtarët e Kuvendit Komunal. Mirëpo, pavarësisht kësaj në disa raste është vërejtur tejkalim i minutazhës së lejuar dhe dalje nga rendi i punës, e përcjellë me tërheqje të vërejtjes nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal. Praktika më të shpeshta janë hasur në rastet kur në rendin e ditës ka pasur pika që kanë trajtuar rregulloret, vendimet për buxhet apo çështjet e ngjashme të kësaj natyre. Nga monitorimi, vërehen paknaqësi, në dhënien sipas rendit/fjalës për diskutime, si dhe ndërhyrje gjatë diskutimeve.

### Ndëhryjet në Punën e Kuvendit

Në proces verbale në disa raste, Këshilltarët Komunal, tëheqin vërejtjen për ndëhryje të Kryetarit dhe Ekzekutivit, në punën e Kuvendit Komunal. Madje, shprehet paknaqësi edhe me mos tëheqjen e vërejtjes nga Kryesuesi i Kuvendit për këto ndëhryje.

### Pengesat gjatë zhvillimit të diskutimeve

Përgjatë monitorimit është vërejtur një dukuri e shtuar e përdorimit të telefonave në punimet e seancave. Kjo dukuri dhe diskutimet jashtë formale pengojnë punën e rregullt në seancat e Kuvendit. Në disa raste, vështirësohet dëgjimi i rrjedhshëm i diskutuesve, ku pamundësohet marrja e qartë e mesazhit për mediat, qytetarët prezent dhe vetë këshilltarët.

### Prezenca e anëtarëve të Kuvendit

Nga të gjeturat e monitorimit, bazuar edhe në procesverbale vërehet mungesat e këshilltarëve, por në disa raste kjo shtohet edhe me mos pjesëmarrje në procesin e votimit. Në këtë periudhë reflektohen mungesat e njëzet e katër (24) këshilltarëve komunal në senaca me gjithsejt pesëdhjetë (82) mungesa apo (32 mungesa me shumë se vitin 2022).

NR SEANCAVE	NUMRI I MUNGESAVE
Një (1) seancë	1 këshilltar komunal
Një (1) seancë	2 këshilltar komunal
Një (1) seancë	6 këshilltar komunal
Një (1) seancë	9 këshilltar komunal
Një (1) seancë	13 këshilltar komunal
Një (1) seancë	15 këshilltar komunal
Dy (2) Seanca	3 këshilltar komunal
Tri (3) Seanca	5 këshilltar komunal
Katër (4) Seanca	4 këshilltar komunal



Mungesat sipas anënatëve të Kuvendit Komunal


Emri	Mbiemri	Subjekti	Numri i mungesave	
1	Ilmi	Hoxha	Kryesues	//
2	Gazmend	Islami	OBKD	14
3	Lirika	Maliqi	LVV	8
4	Adnan	Zymeri	LDK	6
5	Tringa	Sfishta	LDK	6
6	Demokrat	Hodolli	LDK	5
7	Endritë	Murati	PDK	5
8	Ragip	Fetahu	LVV	4
9	Illir	Koprani	LDK	4
10	Arjant	Topanica	LDK	3
11	Bashkim	Syla	PDK	3
12	Florent	Hasani	LVV	3
13	Kasib	Bashota	LVV	3
14	Qëndrim	Softolli	LDK	2
15	Xhevdet	Maloku	LVV	2
16	Drita	Pajaziti	LVV	2
17	Arjeta	Abazi-Salihu	LDK	2
18	Bahri	Blakqori	LVV	2
19	Arbnor	Fazliu	AAK	2
20	Fitim	Muqolli	LVV	2
21	Ekrem	Rrahmani	LDK	1
22	Sebastina	Vokrri	LVV	1
23	Mrika	Thaçi	AAK	1
24	Mimoza Stublla	Abdullahu	PDK	1
25	Naim	Çunaku	LDK	0
26	Haki	Rudari	LVV	0
27	Valon	Demolli	LDK	0
28	Donjeta	Sheqiri	LDK	0
29	Burim	Hasani	AAK	0
30	Artrit	Mulliçi	LVV	0
31	Arnisa	Sylejmani	LDK	0
32	Edona	Shabani	LDK	0
33	Ardi	Hasani	LVV	0
34	Qendrese	Hajrizi	LVV	0
35	Fahri	Hasani	LDK	0

## Angazhimi në seanca

Në periudhen e monitorimit (Janar – Dhjetor 2023), referuar procesverbaleve dhe formularëve të monitorimit të dhënat e përpunuara <sup>1</sup>janë:


- Numri dhe përqindja e diskutimeve në seanca sipas subjekteve politike;
- Lista dhe numri i diskutimeve sipas këshilltarëve komunalë;
- Numri dhe përqindja e këshilltarëve që nuk kanë diskutuar gjatë kësaj periudhe.

Të dhënat tregojnë se në këtë periudhë këshilltarët komunalë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës



kanë diskutuar (493) herë; Lëvizjes Vetëvendosje-LVV, kanë diskutuar (207) herë; të pasuar nga ata të Partisë Demokratike të Kosovës-PDK, (24) herë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK (21) herë; Organizata e Ballit Kombëtar Demokrat-OBKD (8) herë

Të paraqitura në grafikon sipas përqindjeve (%)



Në tabelë janë paraqitur numri i diskutimeve sipas emrave dhe subjekteve politike. (renditja sipas numrit të diskutimeve).

<sup>1</sup> Të dhënat e mbledhura janë kuantitative dhe nuk paraqesin përmbajtjen e diskutimeve.

Renditja e Asambleistëve sipas numrit të diskutimeve (2023)

Nr	Emri	Mbiemri	Subjekti	Diskutimet	Përqindja
1	Ilmi	Hoxha	Kryesues (PDK)	//	
2	Naim	Çunaku	LDK	146	19.36
3	Ekrem	Rrahmani	LDK	94	12.47
4	Haki	Rudari	LVV	75	9.95
5	Qëndrim	Softolli	LDK	59	7.82
6	Valon	Demolli	LDK	57	7.56
7	Arjant	Topanica	LDK	41	5.44
8	Donjeta	Sheqiri	LDK	38	5.04
9	Xhevdet	Maloku	LVV	31	4.11
10	Ragip	Fetahu	LVV	28	3.71
11	Bashkim	Syla	PDK	21	2.79
12	Adnan	Zymeri	LDK	16	2.12
13	Burim	Hasani	AAK	14	1.86
14	Drita	Pajaziti	LVV	13	1.72
15	Sebastina	Vokrri	LVV	13	1.72
16	Artrit	Mulliqi	LVV	13	1.72
17	Arnisa	Sylejmani	LDK	11	1.46
18	Arjeta	Salihu	LDK	11	1.46
19	Edona	Shabani	LDK	10	1.33
20	Florent	Hasani	LVV	9	1.19
21	Gazmend	Islami	OBKD	8	1.06
22	Ardi	Hasani	LVV	7	0.93
23	Bahri	Blakqori	LVV	6	0.80
24	Qendrese	Hajrizi	LVV	6	0.80
25	Mrika	Thaçi	AAK	6	0.80
26	Tringa	Sfishta	LDK	4	0.53
27	Fahri	Hasani	LDK	4	0.53
28	Kasib	Bashota	LVV	4	0.53
29	Mimoza Stublla	Abdullahu	PDK	3	0.40
30	Lirika	Maliqi	LVV	2	0.27
33	Ilir	Koprani	LDK	2	0.27
31	Demokrat	Hodolli	LDK	1	0.13
32	Arbnor	Fazliu	AAK	1	0.13
34	Endritë	Murati	PDK	0	0.00
35	Fitim	Muqolli	LVV	0	0.00

## Ushtrimi i detyrave dhe përgjegjësi të kuvendit komunal

### Hartimi i Politikave

Nga Monitorimi i Punës, nuk ka asnjë rast kur kuvendi ka ndërmarrë iniciativë lidhur me hartimin e politikave lokale. Poashtu nuk ka ndonjë rast kur kuvendi, ka iniciuar një procedurë plotësim-ndryshimi të rregulloreve dhe akteve komunale. Përveç procesit të votimit dhe kontributit në seanca, në asnjë rast kuvendi si tërësi, apo edhe duke krijuar grupe pune, nuk ka trajtuar një politikë, akt, rregullore, apo plan komunal. Përfshirë këtu edhe trupat e Kuvendit. Në proceset e hartimit të buxhetit, kuvendi nuk ka ushtruar mandatin, për tu përfshirë në procesin e hartimit, apo edhe dëgjimeve publike.


### Vendimmarrja

Në pikat e propozuara për votim pjesa më e madhe kanë kaluar, ndërkaq votimi ka qenë i ndarë me votë (për) nga pozita, dhe votë (kundër) nga opozita. Këtu bëjnë përjashtim pikat që vlerësohen të karakterit të përgjithshëm. Si mangësi kyçe del vendimmarrja pa informacion – në të shumtën e proceseve të vendimmarrjes, anëtarët e kuvendit si rezultat i mungesës së trupave profesional, hamendësojnë për proceset e votimit, si rezultat shpesh disa procese kthehen prapa. Në një rast, edhe pse është votuar me shumë propozimi për ndarjen e mjeteve buxhtore në nën-kod të veçantë (transporti i fëmijëve me aftësi të kufizuara në qytet), ekzekutivi nuk e ka vendosur në buxhet. Në disa raste, nëpërmjet vendimeve, pa ndryshuar rregulloren për taksa tarifa dhe gjopa komule, janë marrë vendime për lirime nga pagesat e participimeve.

### Perdorimi i e-mailave zyrtarë

E-mailët e zyrtarë të këshilltarëve nuk janë funksionalë dhe nuk përdoren rregullisht për komunikim nga jashtë. Materiali për seanca dërgohet në e-maila privat, ngase (bazuar në deklaratimet e këshilltarëve) ato janë jashtë përdorimit si pasojë e problemeve me server. Mungesa e funksionimit të e-mailave zyrtarë vështirëson komunikimin ndër-institucional dhe të qytetarëve me të zgjedhurit e tyre. Madje edhe një pjesë e paisjeve (lloptopëve) vlerësohen të amortizuar dhe disa këshilltar kanë refuzuar ti pranojnë.

### Pyetjet për Ekzekutivin



Në bazë të monitorimit të seancave të Kuvendit, “Demokracia Fillon Këtu-DFK” ka evidentuar se përgjatë kësaj periudhe janë shtruar shtatëdhjetë e dy (72) pyetjet nga anëtarët e Kuvendit drejtuar Ekzekutivit. Pyetjet e parashtruara janë paraqitur në bazë të subjekteve politike dhe çështjeve të parashtruara.

Me pyetjet e shtrura në adresë të Ekzekutivit për tema të caktuara shihet se LDK kryeson, e pasuar nga VV dhe AAK; Përderisa nga PDK dhe

OBKD nuk është shtuar asnjë pyetje/çështje për ekzekutivin.

- Lidhja Demokratike e Kosovës, ka shtruar 55 pyetje për Ekzekutivin;

- Lëvizja Vetëvendosje, ka shtruar 15 pyetje për Ekzekutivin;
- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka shtuar 2 pyetje për Ekzekutivin.

Nga numri i çështjeve të ngritura Rrjeti Demokracia Fillon Këtu-DFK, vëren që jo të gjitha pyetjet e anëtarëve të Kuvendit marrin përgjigjet. Në disa raste përgjigjet vonohen, ose nuk kthehen si të plota. Pyetjet e parashtruara bazuar në rrethana të caktuara, në rastin e vonësës përgjigjet vlerësohen jo relevante.

Përderisa kërkesat për sqarime/dokumente kryesisht janë siguruar përmes ligjit për qasje në dokumente zyrtare. Në një proces është përfshirë edhe Agjencia Shtetërore për Informim dhe Privatësi, për shkak të hezitimit nga ekzekutivi ka obliguar dhënin e informacionit.

### Propozimet për pika të reja të rendit të ditës

Gjatë periudhës së monitorimit të Kuvendit Komunal në disa raste kemi pasur propozime për pika të rendit të ditës nga anëtarët e Kuvendit Komunalë. Pikat e propozuara dhe statusi i tyre i trajtimit është:

- **z.Qëndrim Softolli, LDK** : propozim si pikë shtesë që ta kemi një informatë apo raport rreth vërshimeve në Komunën e Podujevës. (nuk miratohet)
- **Valon Demolli LDK**: Propozim për miratim të një Deklarate. Propozoj këtë deklaratë përmes të cilës dua të shprehë mospajtimin tonë me deklaratimet e Kryeministrit Kurti me rastin e 5 vjetorit të vdekjes së Oliver Ivanoviqit, tentimi për glorifikimin e figurës së kriminelit Ivanoviq, e vërtetuar me Vendim të Gjykatës nga EULEX (nuk miratohet);
- **Naim Çunaku LDK**: Propozon që ky Kuvend i Komunës sot në rend të punës ta ketë hartimin, gjegjësisht miratimin e një Deklarate me të cilën ndajmë shqetësimin e qytetarëve dhe të apelojmë në nivelin qendrorë për faljen e borxheve në plotni, gjegjësisht mos hyrjen në fuqi të ligjit i cili parasheh vlerësimin e bazës tatimore të pronës së paluajtshme. (nuk miratohet)
- **z.Ragip Fetahu, LVV** theksoi, duke u bazuar në pikën 7 të ligjit për festat zyrtare të Republikës së Kosovës, propozoj që të futet si pikë e rendit të ditës që data 5 maj të jetë ditë pushimi në Komunën e Podujevës. (miratohet)
- **z.Gazmend Islami, OBKD** theksoi, kam një propozim që të hyjë si pikë e rendit të ditës propozimi për themelimin e zyrës apo drejtorisë për investime të jashtme. (miratohet)
- **znj.Mrika Thaçi,AAK** theksoi, bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, propozoj që pika e renditur e fundit Të Ndryshme të kaloj si pikë e parë e rendit të ditës, dhe të me qëllimin e vetëm që kërkesat, shqetësimet, pyetjet dhe sugjerimet që kanë të bëjnë direkt me qytetarin të marrin vëmendjen dhe adresimin që në fillim të mbledhjes ngase fundja këtu jemi me besimin e qytetarëve dhe përfaqësimit të tyre, andaj dua të besoj shumë në mbështetjen e këtij propozimi nga të gjithë kolegët dhe kolegët e mia sepse nisur nga fakti se as nuk ka ingerenca politike e as individuale. (miratohet)

### Prezenca e qytetarëve

Prezenca e qytetarëve në seancat e Kuvendit për këtë periudhë të monitorimit vlerësohet e zbehtë. Përgjatë mbledhjeve në raste të veçanta ka prezencë nga organizata ndërkombëtare siç është OSBE. Nuk vërehen pjestarë tjerë nga shoqëria civile prezentë në punimet e kuvendit komunal. Ndërkaq, shihet prezenca e mediave lokale, duke përfshirë edhe atë vizive (TV Llapi).

## Zbatimi i Planit të Punës të Kuvendit/Mbikëqyrja e Ekzekutivit

Kuvendi Komunal në Podujevë ka aprovuar planin e punës për vitin 2023. Përmes këtij plani është paraparë dinamika në punimet e Kuvendit Komunal. Bazuar në agjendën e miratuar dhe krahasimi me agjendën e realizuar ka divijime dhe vonesa në implementim sipas tabelës.

Nr.	Planifikimi	Realizimi	Kategoria
<b>JANAR (2023)</b>		<b>REALIZIMI (93%)</b>	
1	Propozim rregullorja për transportin me Taxi	JO	
2	Propozim rregullorja për transportin rrugor		
3	Propozim Vendimi për caktimin e rrjetit të linjave urbano-periferike dhe orari i qarkullimit	PO	
4	Kërkesa për nismen e procedurës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet 6 Komunave	PO	
5	Propozim vendimi për shpallje në interes publik vazhdimi i rrugës së Xhamisë	PO	
6	Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për palestër Sportive	PO	
7	Propozim vendimi për mjete financiare për NP KRM "Pastrimi"	PO	
8	Propozim vendimi për ngritjen e Komisionit përzgjedhës për Dr dhe zv Dr, të shkollave	PO	
9	Propozim vendimi për destinimin e pronës për qendër multifunkionale	PO	
10	Propozim Vendim për venie në diskutim publik programin tre vjeçar të banimit 2023-2025	PO	
11	Propozim vendimi për venie në diskutim publik Plani Komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027	PO	
12	Raporti i punës së Kuvendit për vitin 2022	PO	
13	Të ndryshme	PO	
<b>SHKURT (2023)</b>		<b>REALIZIMI (0%)</b>	
1	Propozim vendimi për Planin vjetor të Punës së Kuvendit Komunal 2023	JO	
2	Informatë nga drejtorja e Administratës	JO	
3	Informatë nga drejtorja e Arsimit	JO	
4	Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2023	JO	
5	Informatë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit	JO	
6	Plani i Prokurimit për vitin 2023	JO	
7	Plani për integritet Komunal 2023-2027	JO	
8	Plani i Mobilitetit	JO	
9	Të ndryshme	PO	
<b>MARS (2023)</b>		<b>REALIZIMI (0%)</b>	
1	Rregullore për Taksa Tarifa dhe Gjoba	JO	
2	Raporti Financiar për vitin 2022	JO	


3	Informatë nga drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit	JO	
4	Informatë nga drejtoria e Inspektionit	JO	
5	Informatë nga drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	JO	
6	Rregullorja për Bonuse të Zonës së Hartës Zonale	JO	
7	Plani i Veprimt në mjedis	JO	
8	Te ndryshme	PO	
<b>PRILL (2023)</b>		<b>REALIZIMI (0%)</b>	
1	Raporti Financiar Janar-Mars 2023	JO	
	Informatë për gjendjen e ambientit në Komunën e Podujevës	JO	
2	Informatë nga drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik	JO	
3	Informatë nga drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	JO	
4	Bartja e të Hyrave vetanake nga viti 2022 ne Vitin 2023	JO	
5	Informatë e punës nga zyra e Auditorit te Brendëshëm	JO	
6	Të ndryshme	PO	
<b>MAJ (2023)</b>		<b>REALIZIMI (29%)</b>	
1	Informatë nga drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	PO	
2	Informatë nga drejtoriae Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë	PO	
3	Statuti i QKMF-së	JO	
4	Raporti i Përformancës së Komunës për vitin 2022	JO	
5	Raporti i punës së Komiteteve të themeleuara nga Kuvendi i Komunës , për vitin 2022	JO	
6	Të ndryshme	PO	
<b>QERSHOR (2023)</b>		<b>REALIZIMI (17%)</b>	
1	Kornixa Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026	PO	
2	Raporti i Auditorit të Përgjithshëm	JO	
3	Rishikimi i Buxhetit për vitin 2023	JO	
4	Raporti 6 mujor nga Kryetari i Komunës	JO	
5	Plani Komunal për barazi gjinore	JO	
6	Të ndryshme	PO	
<b>KORRIK (2023)</b>		<b>REALIZIMI (100%)</b>	
1	Raporti Financiar Janar-Qershor 2023	PO	
2	Informatë nga drejtoria e Arsimit	PO	
3	Të ndryshme	PO	
<b>GUSHT (2023)</b>			
//	Pushim përveç ndonjë mbledhje për ndonjë qështje apo rrethanë urgjente	//	//
<b>SHTATOR (2023)</b>		<b>REALIZIMI (60%)</b>	
1	Miratimi i Projekt Buxhetit për vitin 2024 dhe projektet e vitit 2025-2026	PO	
2	Informatë për përgatitjet e vitit shkollor 2023-2024	PO	
3	Informatë nga drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	JO	
4	Të ndryshme	PO	
<b>TETOR (2023)</b>		<b>REALIZIMI (0%)</b>	
1	Raporti Financiar Janar-Shtator 2023	JO	
2	Informatë nga drejtoria e Inspektionit	JO	

3	Të ndryshme	PO	
<b>NËNTOR (2023)</b>		<b>REALIZIMI (0%)</b>	
1	Ngritja e grupit punues për hartimin e planit të punës për vitin 2024	JO	
2	Informatë nga drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	JO	
3	Informatë nga drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit	JO	
4	Raporti i sektorit të banimit lidhur me banimin social në Komunën e Podujevës	JO	
5	Raport nga kordinatorja e planit te integritetit	JO	
6	Të ndryshme	JO	
<b>DHJETOR (2023)</b>		<b>REALIZIMI (50%)</b>	
1	Plani i punës së Kuvendit për vitin 2024	JO	
2	Informatë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit	JO	
3	Aprovimi i listave të pronave publike për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024	PO	
4	Raporti i Kryetarit të Komunës për vitin 2023	PO	
5	Të ndryshme	PO	

### Realizimi i planit (Janar – Dhjetor) 2023

Referuar planit të punët të planifikuara sipas kategorive:

Kategoria	Planifikimi	Realizimi	Diferenca
Rregullore komunale	4	2	2 më pak se plani
Plane/strategji	8	9	1 më shumë se plani
Vendime	10	63	53 më shumë se plani
Raporte	11	10	1 më pak se plani
Informata	17	4	13 më pak se plani





## Komunikimi i Këshilltarëve Komunalë me qytetarë

Në periudhën e monitorimit, rrjeti i organizatave “Demokracia Fillon Këtu” nuk ka hasur në ndonjë praktikë të takimeve apo diskutimeve të këshilltarëve komunalë me zgjedhësit. Përrjashtim në disa raste, bënë prezenca e disa këshilltarëve në diskutime publike të organizuara nga ekzekutivi.

## Trupat e Kuvendit

Kuvendi në tri raste, gjatë themelimit nuk ka zbatuar legjislacionin në fuqi: i. nuk ka reflektuar përbërjen politike të Kuvendit në përfaqësimin në Komitetin për Komunitete; ii. nuk është përmbushur obligimi i përfaqësimit të barabartë gjinorë; iii. si dhe në procedurën e formimit të komisionit për koordinimin e procesit të përzgjedhjes së këshillave lokalë, ngase nuk ka përmbushur obligimin e përfaqësimit sipas stukturës politike në kuvend. Përtej kësaj, kuvendi ka ndërrmarrë iniciativën dhe themeluar grupin jo-formal të grave.

## Këshillat Lokalë

Referuar të dhënave dhe raporteve periodike, përkundër se Komuna e Podujevës, ka shtrirjen më të madhe në territor<sup>2</sup>, si dhe numrin më të madh të fshatrave<sup>3</sup>, ende nuk ka themeluar dhe konsoliduar këshillat lokalë edhe pse tashmë po bëhen katër vite, kur është miratuar korniza e re, përmes Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për Organizimin, Funksionimin Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane<sup>4</sup>, dy vite, kur rregullorja ka kaluar konsultimin me publikun<sup>5</sup> si dhe shtatë muaj, prej kur është miratuar në Kuvendin Komunal<sup>6</sup>.

Përgjatë këtij procesi, Rrjeti i Organizatave ‘Demokracia Fillon Këtu’, ka ofruar përkrahje në informim<sup>7</sup>, konsultim dhe analiza profesionale<sup>8</sup>. Po ashtu, në proces kemi ofruar propozim për platforma interaktive/inovacion në këtë proces që është reflektuar në rregullore<sup>9</sup>. Në këtë kuadër, është dizajnuar, krijuar edhe harta inter-aktive e këshillave lokalë, që ka për qëllim, informimin, përfshirjen, konsultimin dhe bashkëpunimin mes komunës dhe këshillave lokalë<sup>10</sup>. Komuna e Podujevës edhe pas ri shqyrtimit të vendimit për komisionin për përzgjedhjen e Këshillave Lokalë ka bërë progres të kufizuar në këtë proces.

## Transparenca dhe Llogaridhënia

Për gjatë periudhës së monitorimit, vërehet se Komuna e Podujevës ka siguruar disa mekanizma për transparencë edhe pse nuk ka miratuar strategjinë. Komuna qëndron mirë me publikimin e thirrjeve për seanca, mbledhjeve të komiteteve dhe vendimeve të Kuvendit, kurse obligimet tjera ligjore publikohen me vonesë duke përfshirë të dhënat financiare. Nuk vërehet koordinim me shoqërinë civile për shpërndarjen e mesazhit për aktivitetet e Kuvendit dhe qasjes së qytetarëve në politik-bërje dhe vendimmarrje.

Institucionet komunale përdorin në menyërë efikase rrjetet sociale përmes të cilave informojnë qytetarët dhe promovojnë punën. Ajo qfarë bie në sy, i tërë promovimi është i koncentruar në aktivitetet e Ekzekutivitet dhe në masë mbetet i kufizuar dhe selektiv në pasqyrimi i punës së Kuvendit Komunal dhe trupave të tij.

<sup>2</sup> <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/03/ORGANIZIMI-DHE-FUNKSIONIMI-L-VETEQEVERISJES-LOKALE-NE-KOSOVE.pdf>

<sup>3</sup> <https://gjk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2518>

<sup>4</sup> <https://gjk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>

<sup>5</sup> <https://bit.ly/3aCQ7XC>

<sup>6</sup> <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/08/Rregullore-per-organizimin-e-keshillave-te-fshatrave-dhe-lagjeve-urbane-KKPD.pdf>

<sup>7</sup> <https://drive.google.com/file/d/1h5529snDo3pP9KwBwWbr9-5qTVcDNKE/view>

<sup>8</sup> <https://bit.ly/3LgGoTh>; <http://bitly.ws/wT77>

<sup>9</sup> <https://bit.ly/3Pt8LzD>

<sup>10</sup> <https://dfk-ks.org/harta-e-podujeves/>

## Konsultimet Publike dhe Shtojcat e Proceseve Buxhetore

Përkundër se komuna ka zhvilluar konsultime publike, Komuna, përgjithësisht nuk ka bashkangjitur adresimet nga konsultimet publike, në veçanti statusin e adresimit (pranuar/refuzuar)<sup>11</sup>. Për më tepër në asnjë rast nuk ka hapur thirrje për përfshirjen e palëve të jashtme në gupet punuese (OJQ, profesionist dhe ekspert).

Po ashtu, nuk ka bashkangjitur vlerësimin e Projekteve Kapitale sipas Udhëzimit për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritizimin e Projekteve Kapitale. Përkatësisht, nuk ka publikuar në ueb faqe apo bashkangjitur materialin vlerësimin e projekteve të propozuara për aprovim në Kuvendin Komunal, të përcaktuar në nenin 4, pika 8 e këtij Udhëzimi Administrativ<sup>12</sup> Përderisa, shtojca për Buxhetim të Përgjegjëm Gjinatorë (BPGJ)<sup>13</sup>, është bashkangjitur sipas kërkesave ligjore.

Përgjithësisht, ekziston një shkëputje mes të zgjedhurve dhe zgjedhësve, në proceset e konsultimeve publike në veçanti buxhetit. Përderisa, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përcakton se pas datës 1 shtator duhet ti dorëzohet Kuvendit plan-buxheti nga ekzekutivi. Me këtë rast të zhvilloi procesin e konsultimit deri në miratim 31 shtator<sup>14</sup>.

---

<sup>11</sup> Udhëzimi Administrativ për Shtandartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna;

<sup>12</sup> <https://gjk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21946>

<sup>13</sup> Buxheti Vjetor (2023)

<sup>14</sup> Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;

## Konkluzione:

Rrjeti i Organizatave Demokracia Fillon Këtu - DFK nga të gjeturat e monitorimit të Kuvendit Komunal të Podujevës për periudhën (Janar – Dhjetor) 2023 nxjerr këto konkluzione:

- Konstatohen ndëhryje nga Kryetarit/Ekzekutivit në Punën e Kuvendit Komunal dhe menaxhim i dobët të punimeve në seanca.
- Është rritur ndjeshëm numri i akteve dhe rregullativës që nuk janë në përputhje me legjislacionin;
- Fuqia politike e grave mbetet e dobët, mungon bashkëpunimi ndër-partiak dhe veprimet për fuqizimin gjinor, përkundër se është ndërmarrë iniciativa për themelimin e grupit-jo formal;
- Kuvendi Komunal i Podujevës ballafaqohet me sfida teknike (hapësira pune) për funksionim normal;
- Ekziston një praktikë që procesi i votimit konfirmohet pa votimin e shumicës së anëtarëve prezent dhe marrin pjesë në votim.
- Diskutimet/kontributet në planet, dokumentet dhe politikat strategjike mbesin të mangëta; kjo reflekton mungesë përvoja dhe interesi për zhvillimet afat-mesme dhe afat gjata;
- Trupat e Kuvendit, përjashtuar Komitetet e Obligative, nuk janë të konsoliduara mjaftueshëm dhe pjesërisht funksionale;
- Kuvendi Komunal nuk ka ndërtuar mekanizma të qëndrueshëm në mbikëqyrjen e Ekzekutivit Komunal;
- Agjenda e Punës së Kuvendit Komunal ka shmangie nga Plani i Miratuar;
- Procesi i konsultimit publik i akteve komunale mbetet i mangët dhe me pjesëmarrje të ulët të publikut;
- Angazhimi i Këshilltarëve Komunal në senaca mbetet i ulët;
- Procesi i vendimmarrjes, dominohet nga agjendat partiake dhe mungon dialogu i brendshëm, përjashtimisht për çështjet që indirekt nuk janë politika ekskluzive të Kuvendit;
- Kuvendi nuk e ka ende rolin e plotë në hartimin e dokumenteve dhe politikave, nismat kryesisht vijnë nga Ekzekutivi;
- Kuvendi nuk ka arritur të gjejë konsensus për shtimin e mjeteve financiare për zbatimin e detyrave të tij;
- Mungon koordinimi efikas në mes Sekretariatit të Kuvendit dhe Administratës Komunale në publikimin e akteve dhe aktiviteteve;
- Diskutimet publike mbeten të zbehta, mungon interesimi i publikut për diskutimet e përgjithësuara;
- Dëgjimet buxhetore nuk zhvillohen nga Kuvendi, madje as nuk ka marrë projekt-buxhetin me kohë(1 shtator) siç parashihet në Ligjin për Menaxhimin e Fincave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Ekzekutivi nuk ka zbatuar vendimin e kuvendit për shtimin e nën-kodit buxhetor për transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Mungon një qasje efikase dhe efektive e konsultimit të grupeve të veçanta të interesit;
- Këshilltarët nuk marrin përgjigje me kohë dhe të plota nga Ekzekutivi;
- Mos themelimi i Këshillave të Fshatrave dhe lagjeve pengon legjitimitimin e strukturave përfaqësuese.

## Rekomandime:

### Për Ekzekutivin Komunal

- Të ketë të qartë ndarjen e pushteteve dhe roleve, ku ekzekutivi i jep llogaridhënie kuvendit;
- Të rris bashkëpunimin me Kuvendin Komunal me qëllim të përmbushjes së Planit të Punës;
- Të shtoj përpjekjet për llogaridhënie në raport me Kuvendin Komunal;
- Të ndiqet shembulli i qasjes pro-aktive të komunikimit nga Drejtorët me Këshilltarët Komunal;
- Të vazhdoi punën komisioni për zgjedhje të Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve;
- Të ndërpritet praktika e shmangjes nga obligimet e vendimeve të kuvendit në aktet e miratuara.

### Për Administratën Komunale

- Të rritet azhureteti në publikimin e akteve dhe informatave të Kuvendit Komunal;
- Të publikohen të gjitha vendimet që i merr Ekzekutivi dhe Kuvendi Komunal, në veçanti:
  - Listën e pronave komunale dhe statusin e tyre; dhe
  - Shpenzimet financiare.

### Për Kryesuesin e Kuvendit Komunal

- Të shmangë ndërhyrjet e ekzekutivit mbi punën e kuvendit;
- Të inicioi me urgjencë themelimin Këshillave Konsultativ;
- Të themeloi trupa dhe mekanizma që rrisin mbikëqyrjen e Ekzekutivit;
- Të hartoi strategji të përfshirjes dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, duke përfshirë edhe organizimin e diskutimeve publike;
- Të shtojë përpjekjet për zgjerimin e hapësirave për punë për trupat e kuvendit dhe grupet politike;
- Te konsultoj mirë bazën ligjore para miratimit të akteve komunale;
- Të shtohet efikasiteti dhe saktësia në hartimin e procesverbaleve;
- Të forcojë mbikëqyrjen ndaj ekzekutivit si dhe të ushtrojë funksionet në procesin e hartimit të akteve komunale.

### Për Anëtarët e Kuvendit Komunal

- Të përdorin qasje pro-aktive të informimit, artikulimit dhe adresimit të problemeve të ngritura nga qytetarët;
- Të rrisin komunikimin dhe llogaridhënien karshi zgjedhësve dhe publikut;
- Të shtojnë angazhimin publik dhe profesional në adresimin e çështjeve dhe mbikëqyrjen e ekzekutivit.
- Të shtojë mbikëqyrjen për proceset sikurse themelimi i këshillave lokalë;
- Të ulë ndjeshëm/parandaloj mos harmonizimin me legjislacionin të akteve dhe rregullativës;



**RRJETI DEMOKRACIA FILLON KËTU**

ADRESA: Sheshi i Dëshmorëve, pn.

E-mail: [rrjeti.dfk@gmail.com](mailto:rrjeti.dfk@gmail.com); Mob: +383 (0) 45 223333

Ueb: [www.dfk-ks.org](http://www.dfk-ks.org)

